

	
ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA	
Njësia: Unit:	KO
Nr. Prot.: Prot. No.:	12/2023
Jednica: Br. Prot.:	
Nr. i faqeve: No. of pages:	- 03 -
Data: Datum:	26.12.2023
Br. stranca: Prishtinë	



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

NR. REF 12/2023

KUVENDI I ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1 me nënparagrafin 1.12 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 22, paragrafit 1 me nënparagrafin 1.12 dhe 1.14 dhe Nenit 53, paragrafit 1 me nënparagrafin 1.1 dhe Nenit 54 të Statutit të OMK-së si dhe Nenit 23, paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores për Procedurat Vendimmarrëse të Organeve të OMK-së, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 26 dhjetor 2023, nxjerr këtë:

V E N D I M

për

CAKTIMIN E KUOTËS SË ANËTARËSISË NË OMK

Neni 1

Kuota e anëtarësisë vjetore për mjekët të cilët ushtrojnë veprimtarinë mjekësore në Republikën e Kosovës

I. Kuota e anëtarësisë vjetore për mjekun e punësuar, për mjekun e pensionuar por të punësuar, në shumë prej 100.00 (njëqind)€ (euro);

II. Kuota e anëtarësisë vjetore për mjekun e papunë, në shumë prej 50.00 (pesëdhjetë) € (euro), me kusht që të sjellë dëshminë e listës shpjeguese të pagave e lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), e cila vërteton se nuk ka gjeneruar të hyra më shumë se gjashtë muaj, në periudhën kohore për dymbëdhjetë (12) muajt e fundit.

III. Kuota e anëtarësisë vjetore për mjekun, i/e cili/a e kryen provimin e licencës për herë të parë gjatë vitit kalendarik përkatës pas datës 1 korrik dhe anëtarësohet në OMK, në shumë prej 25.00 (njëzetepesë) € (euro);

IV. Kuota e anëtarësisë vjetore për mjekun shtetas me shtetësi të Kosovës por që jeton jashtë Republikës së Kosovës dhe dëshiron në mënyrë vullnetare të regjistrohet dhe të anëtarësohet në OMK, në shumë prej 100.00 (njëqind) € (euro);

V. Kuota e anëtarësisë vjetore për mjekët me shtetësi të huaj në shumë prej 300.00 (treqind) € (euro);

VI. Lirohet nga detyrimi për të paguar kuotën e anëtarësisë vjetore në OMK, mjeku i pensionuar që nuk ushtron veprimtari mjekësore në territorin e Republikës së Kosovës, me kusht që të sjellë dëshminë e listës shpjeguese të pagave e lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), e cila vërteton se nuk ka gjeneruar të hyra më shumë se gjashtë muaj, në periudhën kohore për dymbëdhjetë (12) muajt e fundit.

VII. Kuotat e anëtarësisë të përcaktuara si më lartë me përjashtim të kuotës së përcaktuar sipas paragraf V të këtij Neni, janë të zbatueshme edhe për shtetasit nga Republika e Shqipërisë dhe banorët nga Lugina e Preshevës si dhe për mjekun shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi dhe të cilët kanë përfunduar studimet në Universitetin e Prishtinës apo sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjet eventuale ndërshtetërore apo rajonale.

Neni 2

Mënyra e ekzekutimit të pagesës së kuotës së anëtarësimit vjetor

I. Mjeku anëtar i OMK-së, i punësuar në institucionet shëndetësore publike në tri nivelet e sistemit shëndetësor, do t'i bëhet ndalesa automatike e kuotës fikse të anëtarësisë vjetore me pagën e muajit shkurt të vitit kalendarik, përmes sistemit të pagave-Payroll.

II. Mjeku anëtar i OMK-së i punësuar në institucionet shëndetësore publike në tri nivelet e sistemit shëndetësor, të cilëve për arsye të ndryshme nuk mund t'iu bëhet ndalesa përmes sistemit të pagave-Payroll si dhe mjeku anëtar i punësuar në institucionet shëndetësore private në tri nivelet e sistemit shëndetësor duhet të realizojnë pagesë direkte në xhirrollogaritë bankare të Odës si dhe të bëjnë dorëzimin e dëshmisë së pagesës në zyrën e anëtarësimit në OMK.

III. Mjeku anëtar i OMK-së, sipas Nenit I të këtij Vendimi, obligohet që detyrimin për pagesën e kuotës fikse të anëtarësisë vjetore në OMK ta bëjë jo më larg se data 30 qershor e vitit kalendarik.

Neni 3

Pasojat juridike për shkelje të obligimit të anëtarësimit

Mjeku i cili nuk i kryen obligimet sipas këtij Vendimi, lidhur me pagesën e kuotës së anëtarësisë, Komisioni për Anëtarësim, Licencim dhe Rilicencim i OMK-së, përmes Vendimit të formës së prerë do t'i ndërpresë anëtarësimin në OMK konform Nenit 15 paragrafit 1 me nënparagrafin 1.4. të Statutit të OMK-së.

Neni 4
Hyrja në fuqi

I.Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha Vendimet që kanë përcaktuar lartësinë e kuotës së anëtarësisë në OMK.

II.Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i OMK-së.

Prishtinë, 26 dhjetor 2023

Kryetari i OMK-së
Dr. Pleurat Sejdiu, Mr.Sci

